



"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENiOR-A "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
 Nr. 10 Viti i dytë i botimit Mars 2014

Ditari Natyrës

Në këtë numër do të gjeni:

- Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut.
- Fillon vlerësimi i vlerave dhe përfitimeve nga Parqet Kombëtare.
- Njoftime.

Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut


Projekti "Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut " (SEA-Med) është pjesë e një përpjekje rajonale e udhëhequr nga WWF, Zyra e Programeve të Mesdheut dhe e përqendruar në 8 Zona të Mbrojtura Detare të vendeve të ndryshme të Mesdheut (Libi, Tunizi, Turqi, Kroaci, Algjeri dhe Shqipëri), duke punuar me turizmin, si sektorin më premtues për zhvillim, financim dhe me pas dhe gjenerimin e të ardhurave të reja për komunitetet lokale. Instituti për Ruajtjen e Natyrës (INCA), e njohur në fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës, është përgjegjëse për zhvillimin e projektit në Shqipëri.

Ky projekt në Shqipëri ka nisur në korrik 2013, me mbështetjen e CEPF, me një kohëzgjatje të përgjithshme prej tre vjetësh. Ai synon të mbështesë zhvillimin e planit të qëndrueshëm të menaxhimit të turizmit për Parkun Kombëtar Detar të Karaburunit - Sazanit dhe zonës përreth, avancimin drejt praktikave të qëndrueshme të zhvillimit në sektorin e turizmit të rajonit të Vlorës, konkretisht komunën e Orikumit dhe shtimin e ofertave turistike që lidhen me Parkun Kombëtar Detar të Karaburun - Sazanit dhe Llogarasë duke angazhuar shumë aktorë lokalë hap pas hapi.

Aktivitetet dhe sfidat e projektit.

Projekti funksionin dhe zbatohet mbi disa shtylla (komponentë) kryesore që do të kenë rol kyç gjatë zbatimit të projektit por edhe në të ardhmen. Grupi i punës është cilësuar si elementi i parë kryesor i projektit, i zgjedhur me përfaqësues nga institucione të ndryshme lokale të cilat kanë lidhje me menaxhimin e ZMD-së. Gjatë zbatimit të projektit ata do të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në planifikimin dhe aktivitetet zbatuese, por mbi të gjitha në menaxhimin e ardhshëm të ZMD-së.

Vijon në faqe 2



Vijon nga faqe 1 Aktualisht është realizuar një vizitë në shtator në Parkun Detar Tavolara (Itali), si një nga zonat e mbrojtura detare aktualisht me menaxhim të suksesshëm dhe efektiv, ku grupi i punës është prezantuar me historinë e zhvillimit të saj, me planet e menaxhimit dhe zbatimin e tyre përgjatë një procesi të gjatë në të cilin janë përfshirë aktorët e ndryshëm.

Projekti u hap më 8 tetor, me pjesëmarrjen e më shumë se 50 personave, duke përfshirë kreun e zyrës së programit të WWF, drejtorin i Biodiversitetit nga Ministria e Mjedisit, ekipin e projektit UNDP,



pjesëmarrës të komunës Orikum, stafi i menaxhimit të ZMD, universiteti publik "Ismail Qemali", organizatat e shoqërisë civile etj. Më 14-18 tetor, u organizua seminari 5 ditor " Hyrje në zonat mbrojtura detare " me trajnerë nga Qendra Kombëtare e Oqeanisë dhe Atmosferës SHBA (NOAA)

dhe WWF. Qëllimi i këtij trajnimi ishte të jepte njohuri bazë mbi zonat e mbrojtura detare dhe menaxhimin e tyre, nëpërmjet kombinimit të leksioneve, prezantimeve të ekspertëve të ftuar lokal dhe kombëtarë në mënyrë interaktive. Për më tepër, Shqipëria është zgjedhur për të organizuar trajnimin rajonal që do të zhvillohet në datat 29 mars - 4 prill. Ky trajnim do të zhvillohet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të projektit nga 5 vendet e Mesdheut, të cilët do të trajnohen për menaxhimin efektiv të ZMD duke mësuar nëpërmjet shkëmbimit të përvojave në këtë drejtim.

Në kuadër të këtij projekti INCA ka nisur kohët e fundit dy studime: "Vlerësim mbi aktivitetet turistike aktive të bazuara në natyrë në Bashkinë e Vlorës dhe

Orikumit" dhe "skemat e certifikimit mbi aktivitetet e qëndrueshme turistike të përshtatshme për Shqipërinë", që janë aktualisht në progres nën mbikëqyrjen e një eksperti ndërkombëtar. Këto studime, kur të finalizohen, do të ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e planit të menaxhimit të integruar të ZMD-së dhe zbatimin e një inisiative pilot për turizmin me bazë natyrën, lidhur me Parkun Kombëtar Detare të Karaburun-Sazanit. Studime të tjera janë duke pritur për të nisur kryesisht mbi strategjinë e komunikimit dhe edukimin.

Duke marrë parasysh punën dhe aktivitetet që janë duke u zhvilluar në këtë zonë në janar, UNDP ka kontraktuar WWF dhe përmes tyre INCA-n, për të zhvilluar Planin e Menaxhimit Parkut Kombëtar Detar të Karaburun - Sazanit. Zhvillimi i këtij projekti është shumë i rëndësishëm jo vetëm për organizatën tonë por ky projekt duam të ketë një ndikim



kombëtar dhe lokal në mënyrën e të menduarit, hartimin e politikave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në të gjithë vendin për ti dhënë përparësi zhvillimit turizmit të qëndrueshëm përmes stimuljeve ekonomike dhe sociale për komunitetet lokale. Ne presim që impakti i këtij projekti të transmetohet nga niveli i qeverisjes vendore dhe lokale në komunitetin lokal dhe do të bëhet pjesë e mënyrës së tyre të jetesës, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe aktiv të turizmit, duke gjeneruar të ardhura nga burimet e natyrës përmes mirëmbajtjes, përmirësimit të shërbimeve, zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe promovimin e produkteve të shëndetshme.

Jemi vetëm në fillimin e një rrugëtimi të gjatë...

Fillon vlerësimi i vlerave dhe përfitimeve nga Parqet Kombëtare

Në kuadër të projektit Parqet e Harkut Dinarik, i cili zbatohet nga WWF dhe INCA, u zhvillua në ambientet e Qendrës së Informacionit të Parkut Kombëtar Dajti, takimi i parë për vlerësimin e përfitimeve që vijnë nga kjo zonë e mbrojtur. Pjesëmarrës në këtë takim ishim përfaqësues të administratës së parkut, përfaqësues të pushtetit lokal, Ministrisë së Mjedisit, përfaqësues nga bota akademike si dhe përfaqësues të bizneseve të zonës. Presioni mbi parqet kombëtare vazhdon të rritet pasi kërkesat për burime natyrore, tokë, ujë janë zgjeruar tej mase. Organizatat që punojnë në mbrojtje të mjedisit mundohen të mbledhin argumente bindëse që mbështesin menaxhimin dhe vazhdimësinë e respektimit të statusit të zonës së mbrojtur jo vetëm si ruajtëse të vlerave unike të natyrës por edhe si mbështetëse të zhvillimit të socio-ekonomik.

Metodologjia për Vlerësimin e Përfitimeve nga Zonat e Mbrojtura (IVPZM) është një metodë e zhvilluar nga WWF për identifikimin e përfitimeve të dukshme e të padukshme që vijnë nga zonat e mbrojtura dhe analizon më tej kush i merr këto përfitime. Duke zbatuar këtë metodologji, takimi për vlerësimin e përfitimeve nga Parku Kombëtar Dajti mbledhi të dhëna mbi përfitimet që vijnë nga larmia e biodiversitetit, nga përdorimi i ujit të basenit ujëmbledhës të këtij parku, të dhëna mbi përfitimet ekonomike të bizneseve dhe popullatës nga turizmi malor si dhe nga mbrojtja e drejtpërdrejtë që

sigurohet kundër proceseve të erozionit dhe zbutjes së klimës.



Një javë më parë, projekti filloi punën në Parkun Kombëtar të Valbonës me përgatitjen e procesit të certifikimit të këtij parku nga Federata Evropiane Europark. Certifikimi ECST, apo thënë ndryshe, anëtarësimi në Kartën Evropiane të Turizmit të Qëndrueshëm është mjet i shkëlqyer për promovimin e turizmit të zonës që do të vendosë parkun Kombëtar të Valbonës në hartën e parqeve evropiane për t'u vizituar. Për të qenë anëtar i suksesshëm i rrjetit elite prej 400 parqesh të Federatës Europark duhet të plotësohen një sërë standardesh në menaxhimin e parkut të Valbonës. Përgatitja e një strategjie zhvillimi së bashku me grupet e interesit dhe ngritja e një forumi të përhershëm të turizmit të qëndrueshëm janë dy prej kriterëve më të rëndësishme në procesin e aplikimit për certifikim të cilat do të mbështeten nga projekti.

**MESSAGE OF THE EXECUTIVE SECRETARY
OF THE CONVENTION ON BIOLOGICAL DIVERSITY
BRAULIO FERREIRA DE SOUZA DIAS**

**on the occasion of
WORLD WILDLIFE DAY
3 March 2014**

“Celebrate and raise awareness of the world's wild fauna and flora”

World Wildlife Day provides occasion to celebrate the wonder and beauty of the world's wild fauna and flora and to reflect on the multitude of benefits provided by wildlife. During this United Nations Decade on Biodiversity, this day reminds us that it is important to resolve to do our utmost to preserve these key components of biodiversity.

Wildlife has the power to bring joy and amaze us. Be

they iconic species, such as lions and tigers, or the gelatinous blobfish, recently voted the world's ugliest endangered species, they are all wonders of nature. Among many cultures, entire habitats or sets of species within a landscape have special spiritual and existence value.

Wild fauna and flora provide benefit to people on many levels – including economic, medical and

Vijon nga faqe 3 scientific, recreational and ecological – and play a crucial role in the ecological and biological processes essential to life itself, supporting healthy, resilient and productive ecosystems.

Ecosystem processes are driven by the combined activities of many species. Plant regeneration, food webs, and plant diversity are amongst the various processes that depend on the presence of fauna.

Therefore activities, such as hunting conducted in an unsustainable manner, have the potential to not only impact targeted species but the ecosystem more broadly. Extractive activities in forests and other natural ecosystems can be disruptive processes, and can alter the overall function, structure and composition of ecosystems, seriously affecting broader development objectives.

Wildlife is vital to many of the world's poorest people. Local animals provide meat protein, local trees provide fuel, and both plants and animals provide components of traditional medicines used by most people in the world. The depletion of wildlife is thus intimately linked to the food security and livelihood of inhabitants of ecosystems around the world as many people have few alternative sources of protein and income.

The benefits from natural wildlife resources and the financial assets obtained locally from these need to be better managed, through mechanisms that enable good governance so that the benefits are sustainable and safeguarded for future generations. There is an urgent need to stop wildlife crime, notably the illegal wildlife trade and poaching which have wide-ranging economic, environmental and social impacts.

Implementing nationally and internationally agreed biodiversity strategies and targets and other relevant



commitments, for example, are helping countries develop frameworks to effectively manage their natural wildlife resources.

The Convention on Biological Diversity (CBD) has an important role in addressing wildlife issues – identifying, for instance, unsustainable hunting of bushmeat and its effect on non-target species as a priority for Parties – and is seeking to heighten awareness on the multiple dimensions of sustainable wildlife management, including through the Collaborative Partnership on Wildlife Management.

The Strategic Plan for Biodiversity 2011-2020, including its twenty Aichi Biodiversity Targets, has been adopted as a universally agreed global framework to conserve, restore and sustainably use biodiversity and enhance its benefits for people. Wildlife conservation is at the heart of this Plan, which includes in its mission to, “take effective and urgent action to halt the loss of biodiversity”. Aichi Biodiversity Target 12, for example, aims to prevent the extinction of threatened species by 2020 and improve the conservation status of those species most in decline.

The sheer breadth and scale of the benefits that wildlife provides is a compelling reason for maintaining wildlife populations and habitats in a productive and healthy state. We have a stronger economy, diverse food products and advancements in medical research all as a result of wildlife and natural ecosystems. It is imperative for ourselves and for future generations that we all take an active interest in their preservation.

NJOFTIME

1- Programet e MSc apo Phd ne fushën e Energjisë lehtesohen dhe promovohen nga Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjise. Për më tepër: (<http://eit.europa.eu/>)

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

• Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro